



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

K R Y E T A R I

Nr. 191/6 Prot.

Tiranë, më 16.06.2016

V E N D I M

Nr. 62, Datë 16.06.2016

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË URDHRIN E STOMATOLOGUT SHQIPTAR MBI ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË SË VEPRIMTARISË EKONOMIKO-FINANCIARE DHE VLERËSUES

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimi mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, Drejtorit Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, në mbështetje të nenit 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Zbatimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare dhe vlerësues”, ushtruar në subjektin e Urdhrit të Stomatologut Shqiptar, për financimin fillestar nga Buxheti i Shtetit.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi:

- Neni 8, pika 1, “Buxheti” i Statutit të Urdhrit të Stomatologut Shqiptar është në kundërshtim me nenin 8, pika 1, “Buxheti” të ligjit 127/2014 “Për urdhrin e stomatologut në Republikën e Shqipërisë”.
- Neni 8, pika 1, “Buxheti” dhe neni 10, pika 1, “Asambletë” i Statutit të Urdhrit të Stomatologut Shqiptar janë në konflikt me njëri-tjetrin.
- Asambleja Kombëtare si organi më i lartë drejtues i Urdhrit të Stomatologut Shqiptar, sipas ligjit ka kompetencën e miratimit dhe administrimit të buxhetit, në përputhje me rregullat financiare. Të drejtën e thirrjes së Asamblesë Kombëtare e ka Presidenti i Këshillit Kombëtar, deri në datën 29.02.2016 Asambleja Kombëtare nuk është mbledhur asnjëherë. Ky veprim është në kundërshtim me Kreun II, neni 5, “Presidenti”, germa “e”, të Rregullores së Brendshme të Urdhrit të Stomatologut Shqiptar, miratuar me vendimin nr. 14, datë 31.07.2015, të Këshillit Kombëtar.
- Vendimi Nr. 09, datë 08.05.2015 dhe Vendimi Nr. 19 datë 31.07.2015 i marrë nga Këshilli Kombëtar dhe të zbardhur nga Presidenti i Urdhrit të Stomatologut Shqiptar janë në kundërshtim me ligjin nr. 127/2014 “Për urdhrin e stomatologut në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht me pikën 1 të nenit 8 në të cilën përcaktohet se të drejtën për miratimin e buxhetit e ka Asambleja Kombëtare.

1.1. Rekomandim:

Presidenti i Urdhrit të Stomatologut Shqiptar, të thërrasë Asamblenë Kombëtare, me qëllim diskutimin e gjetjeve të Raportit të auditimit në lidhje me kundërshtitë ligjore të vërejtura dhe trajtimin e tyre në Asamble duke u referuar në ligjin 127/2014 “Për urdhrin e stomatologut në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullores së Brendshme të Urdhrit të Stomatologut Shqiptar, miratuar me vendimin nr. 14, datë 31.07.2015, të Këshillit Kombëtar dhe konkretisht:

- Ndryshimin e nenit 8 “Buxheti” të Statutit të Urdhrit të Stomatologut Shqiptar për ta sjellë në përputhje me ligjin 127/2014 “Për urdhrin e stomatologut në Republikën e Shqipërisë”, nenin 8 “Buxheti”.
- Çdo vendim i mëvonshëm i Këshillit Kombëtar duhet merret në përputhje me nenin e ri të ndryshuar bazuar në nenin 8, pika 1, “Buxheti” të ligjit 127/2014 “Për urdhrin e stomatologut në Republikën e Shqipërisë”.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi:

- Bazuar në proces-verbalin e mbledhjes Nr. 2, datë 08.05.2015 të Këshillit Kombëtar, pika 4 e rendit të ditës, buxheti është miratuar vetëm në parim dhe nuk ka gjurmë të bërjes transparente për anëtarët e këshillit dhe njohjen e tyre me detajimin e vlerave, të ndarjes së këtij buxheti për çdo zë shpenzimesh. Në Vendimin nr. 9, datë 08.05.2015 të zbardhur nga Presidenti i Urdhrit të Stomatologut Shqiptar buxheti është detajuar në zëra shpenzimesh të cilat nuk rezultojnë të jenë diskutuar dhe miratuar nga Asambleja Kombëtare, që sipas ligjit ka të drejtën e miratimit të buxhetit, apo nga Këshilli Kombëtar.
- Bazuar në proces-verbalin e mbledhjes Nr. 3, datë 31.07.2015 të Këshilli Kombëtar nuk ka gjurmë të diskutimit në parim dhe në detaje për caktimin e nivelit të pagave për Aparatin

Qendror të Urdhrit të Stomatologut Shqiptar, ndërsa Presidenti i Urdhrit të Stomatologut Shqiptar ka zbardhur Vendimin Nr. 19 datë 31.07.2015 i cili nuk përputhet me procesverbalin dhe rrjedhimisht jo sipas vendimmarrjes së Këshillit Kombëtar. Në Vendimin nr. 19 datë 31.07.2015 të zbardhur nga Presidenti i Urdhrit të Stomatologut Shqiptar buxheti është detajuar në zëra shpenzimesh të cilat nuk rezultojnë të jenë diskutuar dhe miratuar nga Asambleja Kombëtare, që sipas ligjit ka të drejtën e miratimit të buxhetit, apo nga Këshilli Kombëtar.

- Nisur nga procedura e diskutimit dhe miratimit të buxhetit në të dy rastet si dhe mospërputhja me përcaktimet e nenit 8, pika 1, “Buxheti” të ligjit 127/2014 “Për urdhrin e stomatologut në Republikën e Shqipërisë”, Vendimi Nr. 9, datë 08.05.2015 dhe Vendimi Nr. 19 datë 31.07.2015 i Presidentit të Urdhrit të Stomatologut Shqiptar konsiderohen të parregullt.

2.1 Rekomandim:

Urdhri i Stomatologut Shqiptar në miratimin e buxhetit të çdo viti të paraqesë në Asamblenë Kombëtare projekt-buxhetin e detajuar në çdo zë shpenzimi dhe pas miratimit në parim ta miratojë atë zë për zë. Mbledhjet e Asamblesë Kombëtare duhet të jenë transparente dhe procesverbali i mbledhjes duhet të pasqyrojë ekzaktësisht çfarë diskutohet në Asamblenë Kombëtare. Vendimet e Presidentit të Urdhrit të Stomatologut Shqiptar nuk duhet të kenë asnjë shtesë tjetër përveç asaj që është vendosur në mbledhjen e Asamblesë Kombëtare.

Menjëherë e në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi:

- Urdhri i Stomatologut Shqiptar, nuk ka programuar shumën e të ardhurave dhe burimet e krijimit të tyre. Projekt buxheti i hartuar nuk ka të evidentuar shumën e të ardhurave që parashikohen të realizohen për 1 vit, por nëpërmjet një tabele janë paraqitur zërat e shpenzimeve, për të cilat nuk ka asnjë relacion shpjegues dhe argumentim për fondet e kërkuara, referuar kërkesave sipas nevojave nga sektorët apo drejtoritë përkatëse.
- Urdhri i Stomatologut Shqiptar, në hartimin e buxhetit, nuk ka reflektuar se sa do të jetë buxheti, shpenzimet që do të kryhen sipas zërave dhe nevojave, mungon dokumentacioni se ku është bazuar institucioni në përcaktimin e prioritetëve dhe shpenzimeve që do të kryhen.
- Urdhri i Stomatologut Shqiptar, nuk ka hartuar dhe miratuar një buxhet real sipas nevojave, nuk ka parashikuar shumën e të ardhurave vjetore të cilat do të krijoheshin nga aktiviteti sipas përcaktimeve ligjore, ka hartuar zërat e shpenzimeve apriori, pa asnjë relacion shpjegues dhe në mënyrë jo transparente me anëtarët e Këshillit Kombëtar, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 127/2014, datë 02.10.2014 “Për Urdhrin e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë”, neni 8 “Buxheti” ku citohet se buxhetin e tij, e miraton Asambleja Kombëtare dhe e administron në përputhje me rregullat financiare në fuqi.

3.1 Rekomandim:

Urdhri i Stomatologut Shqiptar, të marrë masa për të programuar shumën e të ardhurave dhe burimet e krijimit të tyre, shpenzimet sipas zërave dhe prioritetëve me relacione shpjegues për çdo të ardhur dhe shpenzim që do të kryhet, duke bërë procedurat sa më transparente me anëtarët e Këshillit Kombëtar, në përputhje me ligjin nr. 127/2014, datë 02.10.2014 “Për Urdhrin e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë”, neni 8 “Buxheti”, ku citohet se buxhetin e tij, e miraton Asambleja Kombëtare dhe e administron në përputhje me rregullat financiare në fuqi.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi:

- Mungon analiza e realizimit të buxhetit sipas zërave, ku të përcaktohen drejtimit dhe prioritetet e shpenzimeve që do të kryhen, si edhe të analizohen mangësitë e konstatuara në administrimin e burimeve njerëzore, mjeteve financiare dhe burimeve materiale të urdhrit, në kundërshtim me Kreun II, neni 6, “Sekretari i Përgjithshëm”, të Rregullores së Brendshme të Urdhrit të Stomatologut Shqiptar, miratuar me Vendimin nr. 14, datë 31.07.2015, të Këshillit Kombëtar dhe Rregulloren e Brendshme për sektorin ekonomik, miratuar me Vendimin nr. 23, datë 02.11.2015, pikat 1 dhe 4.

4.1 Rekomandim:

Urdhri i Stomatologut Shqiptar, të analizojë realizimin e zërave të shpenzimeve, mangësitë e konstatuara dhe faktorët që kanë ndikuar në realizimin ose mosrealizimin e objektivave, me qëllim hartimin e një buxheti real për periudhat në vazhdim ku të përcaktohen drejtimit dhe prioritetet sipas drejtimeve të përcaktuara në ligjin nr. 127/2014, datë 02.10.2014 “Për Urdhrin e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë”, Rregulloren e Brendshme të Urdhrit të Stomatologut Shqiptar dhe rregulloren e miratuar për sektorin ekonomik.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi:

- Mungojnë kërkesat për blerje mallrash dhe kryerje shërbimesh nga degët, si edhe analiza e çmimeve të mallrave për llogaritjen e vlerës së tyre, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu I, neni 4, e Kreu II dhe V si edhe me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 92, datë 29.12.2011 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

5.1 Rekomandim:

Urdhri i Stomatologut Shqiptar, për realizimin e objektivave dhe aktivitetit të tij sipas ligjit, të marrë masa për hartimin e kërkesave sa më reale sipas nevojave të rajoneve dhe degëve, referuar kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Menjëherë e në vazhdimësi

Shënim: Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet tu vendosen në dispozicion anëtarëve të Urdhrit të Stomatologut Shqiptar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve, Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R